



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:203855

Datë: 04.03.2022

Numri i dokumentit: 02777335

P.nr.992/21

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e praktikantes Manjola Xhoxhaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.J. nga Prizreni, për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248. par. 1 dhe 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren PP/IL.nr. 1727-13, të datës 14.09.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, në praninë e Prokurorit të Shtetit në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm Mehreme Hoxha, të akuzuarit A.J. dhe mbrojtësit të tij av. N.E. si dhe të dëmtuarës R.J. me datë **03.03.2022**, publikisht mori dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

A.J. nga i ati Q. e ëma M. e lindur Z. i lindur me datën në Prizren, ku edhe tani jeton në rr. lagjja ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar si vozitës dhe përkthyes në KFOR-in turk si dhe predikues fetar, i martuar, babë i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Se me datën 15.08.2021, rreth orës 01:30, në Prizren, saktësisht në banesën e përbashkët familjare, i pandehuri me qëllim të cenimit të dinjitetit brenda një marrëdhënie familjare, shkakton dhunë dhe keqtrajtim fizik e psikologjik të dëmtuarës – dhe vajzës së tij të mitur R.J. ashtu që deri sa e dëmtuara ishte në qytet me shoqet e saja dhe në momentin kur kthehet në shtëpi takohet me babain e saj të pandehurin A.J. i njëjti fillon të i bërtas të dëmtuarës, përse nuk po e hap telefonin e më pas fillon ta sulmoj fizikisht të njëjtën duke e goditur me shuplaka në fytyrë, me të cilat veprime të dëmtuarës nuk i janë shkaktuar lëndime të dukshme trupore.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: Dhuna në familje, nga neni 248. paragrafi 1. dhe 2. të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të nenit 4, 7, 8, 9, 10, 38, 39, 43, 46. par. 1. pika 1.1, 47, 48, 49. dhe 69. të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP-së dhe, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në qoftë se i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

DËNIM ME GJOBË

Në lartësi prej **300 € (treqind euro)**, te cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur 20 € për një ditë burgim, përkatësisht 15 ditë burgim.

Pala e dëmtuar R.J. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil-juridik.

Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, dhe në emër të kompenzimit të viktimave të krimit shumë prej 30 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr. 1727-13, të datës 14.09.2021, kundër të akuzuarit A.J. nga Prizreni, për shkak të veprës penale dhuna në familje nga neni 248. par. 1. dhe 2. i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Në seancën fillestare në prezencën e palëve pasi që u lexua aktakuza nga ana e Prokurorit të shtetit, Gjykata shpalosi dhe bëri prezentimin e të gjitha provave materiale në të cilat mbështetet aktakuza e parashtruar ndaj të akuzuarit. E dëmtuara deklaroi se të pandehurin e ka prind me të cilin jeton së bashku në një familje, se ka raporte shumë të mira dhe të shkëlqyeshme prindërore dhe familjare, në momentin kritik ka qenë mosmarrëveshje verbale por pa ndonjë qëllim të veçantë, por këtë rast në polici e kanë paraqitur fqinjët e jo ajo sepse ajo prindin e don dhe nuk e paraqet në polici, jeton së bashku me të, e respekton dhe poashtu edhe prindi i saj e respekton atë, nuk do të parashtron kërkesë pasurore-juridike, nuk i bashkangjitet ndjekjes penale ndaj prindit dhe e lut gjykatën që deklaratën e saj ta merr si rrethanë lehtësuese.

I akuzuari deklaroi se e pranon fajësinë duke theksuar se është penduar për një veprim të tillë, ka qenë moment i çastit, mosmarrëveshje verbale, të dëmtuarën e ka vajzë, jetojnë bashkë me një familje, kujdeset për vajzën e tij, mundohet në çdo moment t'ia plotësojë kushtet për të cilat ka nevojë vajza e tij, premton dhe zotohet se më kurrë nuk do të përsërisë veprime të tilla, ka gabuar, kërkon falje, është mbajtësi i vetëm i familjes, është baba i katër fëmijëve, çdo herë

kanë pasur raporte të mira prindërore familjare, si dhe e lut gjykatën që t'i shqiptojë një dënim sa më të butë.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.J., av. N.E. deklaroi meqenëse i mbrojturi i tij e ka pranuar fajësinë, është pënduar për një veprim të tillë antiligjor, premtoi se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të njëjtë dhe të ngjashme penale, rrethanat në të cilat është kryer kjo vepra paraqesin kushte nëpërmjet të cilave një vendim eventual i shqiptuar ndaj tij do të shkonte në rrethana esencialisht lehtësuese duke propozuar një dënim të kushtëzuar dhe dënim minimal me të holla si masa që i njëjti në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të njëjtë apo të ngjashme.

Prokurori i Shtetit nuk e kundërshton pranimin e fajësisë për veprën penale e cila i vihet në barrë nga ana e këtu të akuzuarit meqenëse i njëjti pranim i fajësisë është në përputhje të plotë me nenin 248 të KPP-së si dhe provat personale të cilat i përmban aktakuza.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Se me datën 15.08.2021, rreth orës 01:30, në Prizren, saktësisht në banesën e përbashkët familjare, i pandehuri me qëllim të cenimit të dinjitetit brenda një marrëdhënie familjare, shkakton dhunë dhe keqtrajtim fizik e psikologjik të dëmtuarës – dhe vajzës së tij të mitur R J. ashtu që deri sa e dëmtuara ishte në qytet me shoqet e saja dhe në momentin kur kthehet në shtëpi takohet me babain e saj të pandehurin A.J. i njëjti fillon të i bërtas të dëmtuarës, përse nuk po e hap telefonin e më pas fillon ta sulmojë fizikisht të njëjtën duke e goditur me shuplaka në fytyrë, me të cilat veprime të dëmtuarës nuk i janë shkaktuar lëndime të dukshme trupore.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht është paraqitur në gjykatë dhe ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata, konform nenit 257 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa presion dhe mbështet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së, dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet të veprës penale dhuna në familje nga neni 248 par. 1 dhe 2. i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, dhe për këtë gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht dhe dënimin me gjobë, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penalo-juridike.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, nuk ka gjetur rrethana rënduese, e si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, pendimi i thellë, është pënduar thellë, është mbajtës i vetëm i familjes, premtoi dhe zotohet se në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të tilla kundërligjore, andaj e lut gjykatën që t'i shqiptojë një dënim sa më të butë. Andaj gjykata i shqiptoi dënimin me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në afat prej 1 (një) viti, nëse i akuzuari nuk kryen vepra të re penale, dhe dënimin me gjobë në shumën prej 300 (treqind) euro duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko-civil është marrë në kuptimin e nenit 463. par.1.dhe 2. të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim te nenit 453. par. 1. të KPP.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

2021:203855, 03.03.2022

G j y q t a r i

Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.